

FJALA E DEPUTETIT ISUF ÇELAJ

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Tropojës, Hasit, Kukësit dhe të gjithë Shqipërisë, E dëgjuam programin e paraqitur nga Kryeministri dhe na krijoi idenë se pas katër vjetësh do të lëmë pas Zvicrën, Gjermaninë, Danimarkën e Norvegjinë. Në fakt, realiteti është krejt i trishtë, krejt ndryshe. Fatkeqësisht, ka një ngjashmëri të frikshme ndërmjet zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit dhe zgjedhjeve të 31 marsit 1991. Siç duket, duke pasur këtë ngjashmëri, edhe fatin do ta kenë të njëjtë deri në fund. Ne gjatë fushatës elektorale çdo ditë u ofronim shqiptarëve një program të Partisë Demokratike, një nga më të mirët e ofruar në këta tridhjetë vjetët e fundit, bazuar plotësisht në nevojat reale të qytetarëve tanë. Por gjatë natës partia-shtet blinte varfërinë, skamjen e shqiptarëve, i shantazhonte ata me të gjitha format. Ashtu si tridhjetë vjet më parë, partishtet përdori të gjitha makinerinë e saj për blerjen e votave: presionin psikologjik nëpërmjet sistemit të patronazhimit, shantazhoi në mënyrë të vazhdueshme punonjësit e administratës publike dhe biznesin, presione me metodat e ishSigurimit të Shtetit mbi qytetarët, si: “Pse shkuat në takim me deputetin e PD-së? Pse i bëni like në Facebook? Pse e ndiqni fushatën e tyre online?” Pra, këta përdorën metoda që vetëm këta dinë t’i përdorin dhe t’i aplikojnë, si: duke u bërë presion për bukën e gojës, duke i shantazhuar, duke përdorur fondet publike dhe punësimet në prag dhe gjatë fushatës, duke shtuar numrin e përfituesve të asistencës sociale, duke përdorur lidhjet me strukturat kriminale, paratë e aktiviteteve kriminale, si hashashi e të tjera, fakte këto të konfirmuara edhe në raportin e OSBE/ODIHR-it. Pra, ne patëm përballë një shtet të tërë, një makineri të tërë monstruoze, të kapur nga tentakulat e krimit e të korrupsionit, që kishte një qëllim: marrjen e pushtetit me çdo çmim, me dhunim të hapur të çdo parimi demokratik dhe të moralit.

Çdo qelizë e shtetit ishte në shërbimin tuaj dhe në oponencë me Partinë Demokratike e opozitën: policia, ushtria, makinat, helikopterët, radarët, administrata, bashkitë, buxheti, korona, pandemia. Të gjitha këto ishin në funksion të grabitjes së zgjedhjeve. Unë e di se shantazhi dhe propaganda janë në gjenet tuaja politike. E kuptoj se akoma nuk i perceptoni dot shqiptarë të lirë para kutisë së votimit, nuk e perceptoni dot akoma alternativën. Ju asgjësoni çdo parim demokratik, duke iu shfaqur me delir shqiptarëve, jo me vepra, njëlloj si dikur etërit tuaj politikë: që më të mirë se ne nuk ka, dhe se Shqipëria është fanar ndriçues në brigjet e Adriatikut. Kjo ka qenë situata e përgjithshme nga Tropoja në Konispol. Megjithatë, banorët e Tropojës, njohur ndryshe si Malësia e Gjakovës, ata të Hasit e të Kukësit, nuk iu dorëzuan shantazhit, por votuan Partinë Demokratike, programin dhe vizionin e saj, me shpresën për një të ardhme më të mirë për ta dhe fëmijët e tyre. Gjej rastin t’i falënderoj publikisht për mbështetjen prej tridhjetë vjetësh të Partisë Demokratike dhe të alternativës sonë në zgjedhjet e 25 prillit. Qarku i Kukësit është qarku më i varfër i vendit. Në këta tetë vjet të qeverisjes suaj ishte i destinuar të varfërohej edhe më tej, pasi statistikat zyrtare tregojnë se ekonomia e tij është futur në një trend rënës, ndërkohë që nuk ka asnjë ndërhyrje nga qeveria juaj dhe nga qeverisja lokale. Për t’i dhënë fund kësaj situatë të vështirë dhe denigruese për banorët punëtorë, bujarë dhe qëndrestarë të këtyre qarqeve, në veçanti Tropoja dhe Hasi kanë numrin më të ulët të të punësuarve në vend, me 1,4%, ndërkohë që të ardhurat për frymë janë 35,7% më të ulëta se mesatarja e vendit, duke bërë që familjet në qarkun e Kukësit të kenë shpenzimet më të ulëta në rang vendi. Bujqësia dhe blegtoria në këtë qark zënë 41% të ekonomisë, por rajoni ka mungesë totale të investimeve në këtë sektor.

Konkretisht, edhe sot, pas tetë vjetësh të qeverisjes suaj, tropojanët vazhdojnë të kenë të njëjtat halle e probleme, një pjesë e të cilave janë përkeqësuar edhe më shumë. Vazhdon të jetë një gjendje e mjerueshme e infrastrukturës rrugore në fshatra, në pjesën më të madhe të të cilave mund të kalohet vetëm me fuoristradë ose me traktor. Mungesa e investimeve në sistemin e kanaleve vaditëse mbetet një problematikë madhore. Rrjeti i energjisë elektrike vazhdon të jetë tejet i amortizuar, sepse vazhdon të jetë ai i viteve '70. Ndonëse ai është rrethi i dytë në rang kombëtar për prodhimin e energjisë, banorëve u mungon energjia elektrike. Si mund të flasim për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit për Valbonën, që është një perlë, Currajin e Epërm, Nikaj-Mërturin, Bjeshkët e Tropojës, Bjeshkët e Hasit e të Kukësit, kur s'ka rrugë, kur s'ka energji, kur s'ka ujë të pijshëm. Si rrjedhojë, ndodh ai fenomeni tjetër: braktisja. Jemi qarku me emigracionin më të madh në rang republike.

Slogani i kësaj qeverisjeje në këtë tetë vite, por edhe në program, shquhet si qeveri e shërbesave, si qeveri që u ka ofruar shërbim tërë qytetarëve etj. Vetëm për malësorët e Tropojës, për banorët e rrethit të Tropojës, shërbimet në këta tetë vjet nuk janë ofruar, por janë larguar së paku me 200 kilometra. Për një vulë në certifikatë, qytetarëve të Tropojës u duhet të përshkojnë 200 kilometra, për të shkuar në Kukës. Për të koaliduar makinën i duhet të përshkojnë 200 kilometra, të presin në radhë atje, duke u përballur edhe me punonjësit e korrumpuar, duke paguar para nën dorë, duke mbajtur radhën, jo ndizet sinjali majtas, jo ndizet sinjali djathtas, jo mbajnë frenat, jo s'mbajnë frenat, kështu që kur kthehen në shtëpi, kthehen edhe të rraskapitur, edhe të vjedhur, edhe të përbuzur. Prandaj, këto janë ato benefitet që ka pasur qarku i Kukësit, ku bën pjesë edhe Tropoja, edhe Hasi, që unë dhe zoti Hoxha përfaqësojmë. Të nderuar qytetarë të Tropojës, të Hasit e të Kukësit, Unë dhe Partia Demokratike do të angazhohemi çdo minutë dhe çdo sekondë, brenda dhe jashtë këtij parlamenti, që t'ju rikthejmë dinjitetin ju dhe të gjithë shqiptarëve. Kjo qeveri e dështuar pa filluar akoma punën, nuk mund t'i trajtojë shqiptarët si qytetarë të botës së tretë, e ndërkohë të pretendojmë Europën. Liria, demokracia, dinjiteti e prosperiteti burojnë nga vota e lirë. Ajo është alfa e një sistemi të qëndrueshëm demokratik dhe baza e zhvillimit dhe e prosperitetit të këtij vendi. Faleminderit!